

## RELACION

Informacionin e kërkuar në lidhje me Kampusin e Universitetit të Tiranë

Pas miratimeve përkatëse në organet kolegjiale të Rektoratit, Senatit, Këshillit të Administrimit dhe detyrës së projektimit (termave të referencës) u arrit që në vitin 2011 të hartohej projekti i zbatimit me vlerë 99.7 milion lekë, (712 mije euro), nga të cilat financimi nga buxheti i shtetit ishte 48.8 milion lekë, (350 mije euro), ose ~50%. Vlera e përgjithshme e preventivit për ndërtimin e kampusit arrin në 4.8 miliard lekë, (34.3 milion euro).

Ky projekt me sipërfaqe funksionale 53 mijë m<sup>2</sup>, do të ketë në strukturën e tij:

1- *Tri godina për fakultete, ku përfshihen:*

*Ambientet e mësimdhënies; salla leksione, salla seminare, laboratorë, zyra administrative, ambiente shërbimi.*

2- *Një godinë polifunksionale ku përfshihen:*

*Biblioteka qendrore universitare, Auditori qendror “tip amfiteatër”, Salla e Senatit, Zyra administrative, Qendra për IT, Ambiente shërbimi.*

3- *Hapesira sportive, ku përfshihen:*

*Paletta qendrore, Fushat sportive; basketboll, volejball, tenis, minifutboll, Pista e atletikës*

4- *Ambjente të përbashkëta rekreative dhe shplohëse:*

*Parkime për automjetet, lulishte, stola për studentët gjatë kohës së lirë.*

Në përfundim të procedurave të gjata të aplikimit, Këshilli Kombëtar i Territorit miratoi lejen zhvillimore komplekse me Vendimin nr.1 datë 29.5.2013, për ndërtimin e objektit: “Shtese ambiente për Universitetin e Tiranës”.

Me qëllim zbatimin e lejes zhvillimore, më tej u bënë aplikimet për leje ndërtimore teknike, fillimisht pranë Bashkisë Tiranë si enti administrator i territorit, i cili për shkak të ndryshimit të ligjit të urbanistikës në atë kohë, e ktheu aplikimin për kompetence të Ministrisë së Linjës, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Kështu me shkresat nr.1247 prot., datë 06.5.2014 dhe nr.1247/1 prot., Universiteti i Tiranës i është drejtuar MAS, me kërkesën për pajisjen me formularin e lejes së ndërtimit, të nënshkruar nga Ministria e Linjës, sikurse obligon Vendimi nr.1 datë 29.5.2013, në pikën 2 të tij.

Por përveç kësaj situatë të paqartë për Universitetin e Tiranës ka dalë dhe një problematike tjetër që lidhet me pronësinë e terreneve sportive ku është planifikuar të ndërtohet Kampusi si për regjistrimin e kësaj prone, ashtu edhe për tjetërsimin pjesor dhe provizor që ka bërë Bashkia e Tiranës për ndërtimin e një terminali transporti dhe parkimi publik të automjeteve.

Në këto kushte, Universiteti i Tiranës, në zbatim të nenit 3 pika 6 dhe 82 të Ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” formalizoi me VKM nr.430 datë 2.7.2014 dhe VKM nr.988 datë 9.12.2015, duke miratuar inventarin e pronave që UT ka në përgjegjësi administrimi.

Por kur dërgohet aplikimi për regjistrimin e këtij inventari në ZVRPP (Hipoteka), nga kjo e fundit kthehet përgjigje refuzuese, me pretendimin se prona “Terrene Sportive” është regjistruar në emër të Ndërmarrjes së Trajtimit të Studenteve Nr. 1.

Ky fakt është kundërshtuar menjëherë nga Universiteti i Tiranës, duke ju drejtuar të gjithë instancave që nga NTS Nr.1, ZVRPP, MAS, Këshillit të Ministrave dhe së fundi në Gjykatë. Lidhur me këtë situatë të fundit sqarohet si me poshte:

Me VKM nr.215 datë 15.7.1991 “*Për riorganizimin e Unviersitetit të Tiranës*” dhe në bazë të Marrëveshjes së datës 2.9.1991 të dalë në zbatim të këtij Vendimi, është vendosur që Universitetit të Tiranës, që rezulton pas ndarjes dhe krijimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, i mbetet në përgjegjësi administrimi ndër të tjera, edhe Klubi Sportiv “Studenti”.

Terrenet sportive përpara viteve '90 kanë qenë në përdorim të Klubit Studenti, e pas ndarjes dhe riorganizimit të Universitetit të Tiranës në vitin 1991, ky klub së bashku me terrenet sportive u janë lënë në përdorim UT-së. Në ato vite, UT-ja ka qenë në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe kjo e fundit administronte pronat. Më vonë, pasi nga të gjitha institucionet është bërë inventarizimi i pronave shtetërore që ato kishin në përgjegjësi administrimi, Këshilli i Ministrave në vitin 2006 miraton listën e inventarit të pronave që UT-ja kishte në përgjegjësi administrimi, prona këto të ndodhura në Bashkinë Tiranë të Qarkut Tiranë. Ky vendim është përcjellë për veprim në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Këtë e provon korrespondenca që Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka mbajtur me ZVRPP Tiranë me shkresën nr.2139/1 datë 11.4.2007, kthim përgjigje me të cilën thuhet “*Në përgjigje të shkresës tuaj nr.2320 datë 3.4.2007, bashkëlidhur ju dërgojmë kopjen e VKM nr.834 datë 13.12.2006... ku specifikohet statusi juridik i pronës së regjistruar në sistemin hipotekor me nr.1832 datë 9.5.1995....*”

Një shkresë e tillë është fillesë prove që vërteton pronat që UT kishte në përgjegjësi administrimi, që janë regjistruar në sistemin hipotekor ndër vite dhe nuk janë prona të kaluara rishtazi në përgjegjësi të UT-së. Ndër vite, institucioni ynë ka administruar pronën terrene sportive duke e përdorur atë për mësimdhënie, ka pasur të pasqyruar në asetet e veta nëpër bilance këtë pronë, në mënyrë të pandërprerë.

Me VKM nr.834 datë 13.12.2006 “*Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Tiranë, të Qarkut të Tiranës*” sipërfaqja truall prej 194.500 m<sup>2</sup> e ndodhur në ZK 8160 S-12 me nr.pasurie 7/10 me emërtimin terrene sportive është në përgjegjësi administrimi të Universitetit të Tiranës.

Më vonë, bazuar në kërkesat që ligji nr.9741 datë 21.4.2007 “*Për arsimin e lartë në RSH*” të ndryshuar neni 82, UT ka paraqitur në Agjencinë e Inventarizimit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, inventarin e pronave që UT kishte në përdorim. Me VKM nr.430 datë 2.7.2014 dhe VKM nr.988 datë 9.12.2015, është miratuar inventari i pronave që UT ka në përgjegjësi administrimi. Janë të njëjtat prona që UT ka patur në administrim që në vitin 1991, më pas me VKM nr.834 datë 13.12.2006, përfshirë edhe terrenet sportive.

Nga ana tjetër, me VKM nr.403 datë 22.4.2009 “*Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë anonime “Trajtimi i studentëve nr.1”*”, është miratuar lista e inventarit të pronave që kjo ndërmarrje ka, të cilat janë godinat – bujtina të Qytetit Studenti, së bashku me territoret midis tyre, mensa, magazinë, lavanderia, kaldaja me

sipërfaqe funksionale 220.831,8 m<sup>2</sup>. Nga Ndërmarrja e Trajtimit Studentor nr.1 janë kryer procedurat e regjistrimit të pronës më vitin 2015 dhe janë marrë certifikatat përkatëse.

Ndër vite kemi patur korrespondencë me ZVRPP Tiranë për gjendjen juridike të pronës terrene sportive dhe na është dhënë informacioni i kërkuar prej kësaj zyre. Kështu, me shkresën nr. 1220 datë 14.05.2012 e UT-së, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku i është kërkuar dokumenti zyrtar i freskët i hartës treguese të regjistrimit të territorit të vijëzuar; kufijtë e pronës; sipërfaqja totale e pronës. Me shkresën nr.6249/1 datë 23.5.2012 ZVRPP ka dërguar informacionin e kërkuar.

Pronat shtetëtare që Universiteti i Tiranës ka patur në përdorim prej shumë vitesh janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme të ZVRPP Tiranë me volum 27, faqe 250 dhe volum 28, faqe 3 në Zonën Kadastrale 8160.

Sikurse u përmend me lart, në vitin 2013 me Vendimin nr.1 datë 29.5.2013, Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar leje zhvillimore komplekse për ndërtimin e ambjenteve shtesë për Universitetin e Tiranës. Përpara marrjes së kësaj leje, ndër dokumentacionin e mbledhur nga ana jonë me qëllim dorëzimin e dosjes pranë Sekretariatit Teknik të KKT, kemi marrë informacion edhe nga ZVRPP me shkresën nr.6246/1 datë 23.5.2012 me të cilën na është dhënë informacioni i kërkuar me të dhënat për pasurinë në zonën kadastrale 8160 truall me sipërfaqe 107.160,4 m<sup>2</sup>, sipas azhurnimit të bërë deri në datën 31.12.2009, së bashku me hartën e nxjerrë nga zyra. Në rast se prona terrene sportive, nuk do të ishte në përgjegjësi administrimit të UT, ZVRPP Tiranë nuk do të na jepte informacionin e kërkuar.

Po ashtu nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës me shkresën nr.10359/1 datë 24.12.2012 është dhënë *“miratimi për kryerjen e rikonstruksioneve dhe investimeve në pronat e administruara nga UT dhe konkretisht territori i terreneve sportive të Qytetit Studenti në pronësi dhe administrim të UT, ZK 8160, regjistruar me volum 27, fq 250 dhe volum 28 fq.3...”*.

Kemi marrë dijeni se prona terrene sportive janë regjistruar në përgjegjësi të Ndërmarrjes së Trajtimit Studentor nr.1 Tiranë vetëm pas shkresës nr.40461/1 datë 22.2.2016 nga ZVRPP Tiranë e cila shprehet se *“Prona nuk mund të regjistrohet në përgjegjësi të UT-së pasi më datë 12.4.2013 në sportelet e zyrës është paraqitur përfaqësuesja e Ndërmarrjes e cila ka paraqitur VKM nr.403 të shoqëruar me planvendosjen e sipërfaqeve që do t'i kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë anonime “Trajtimi i Studentëve”. Në kushtet kur krijohet mbivendosje e pronës që UT pretendon për regjistrim me pronën e regjistruar për sh.a Trajtimi Studentor nr.1, nga ZVRPP Tiranë nuk mund të procedohet me lëshimin e certifikatës së pronësisë në favor të UT.”*

Për këtë, kemi paraqitur ankesën ndaj qëndrimeve të ZVRPP Tiranë pranë Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe pranë Kryeministrit me shkresat nr.5016/5 datë 5.5.2016 dhe nr.5016/8 datë 22.6.2016. Nga ana e të dy institucioneve ka patur reagime duke urdhëruar ZVRPP Tiranë të pasqyrojë në regjistrat e pasurive të paluajtshme pronat që UT ka në përgjegjësi administrimi sipas VKM nr.988 datë 9.12.2015. Gjatë kësaj kohe kemi pritur qëndrimin zyrtar dhe vetëm më 14.6.2016 na është përcjellë shkresa nr.15839/1 datë 9.6.2016 e ZVRPP Tiranë se jemi përpara mbivendosjes së dy titujve të pronësisë dhe se zyra nuk mund të procedojë me regjistrimin e VKM nr.988 datë 9.12.2015 deri në zgjidhjen e situatës.

Për këtë çështje është paraqitur padi në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë e cila nuk është pranuar dhe momentalisht ndodhet në gjykim në apelin administrativ sipas ankimit të bërë nga drejtoria juridike.